



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 471/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Ferit Osmani dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Fushë Kosovë, paraqitur kundër Ibrahim Xhakolli – Kryesuese e Vendvotimit nga Fushë Kosova, Bekim Rexha nga Fushë Kosova, Ruxhdi Raqi nga Fushë Kosova, Labinot Kelmendi – Komisioner i LDK-së dhe Fitore Qerimi – Vëzhguese nga Fushë Kosova, për shkak të pa rregullsive gjatë procesit të votimit, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 07.11.2013, mori këtë:

VENDIM

REFUZOHEN si të pabazuara ankesat e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Fushë Kosovë : Anr.471/13, Anr.472/13, Anr.473/13, Anr.474/13.

Arsyetim

Me datën 04.11.2013, subjekti politik PDK, ka parashtruar 4 (katër) ankesa në PZAP, Anr.471/13, Anr.472/13, Anr.473/13, Anr.474/13, për shkak të pengimit të procesit të rregullt votues, në Zgjedhjet Lokale të datës 03. Nëntorit 2013 .

- Në ankesën Anr. 471/13, pretendohet se sot rreth orës 13:00 në shkollën fillore “Mihail Grameno” i njëjti vendvotim, Ibrahim Xhakolli në cilësinë e kryesueses për vendvotim (VV) nr.4, personave Ruzhdi Rexha dhe Bekim Rexha iu bënë të mundur që të votojnë edhe pse identifikuesi në dritë është pozitiv. Parashtruesi i ankesës e ka cekur në cilësi të dëshmitarëve personat Arben Selmani, Gentrit Grajçevci, Liridon Gashi dhe Floreta Dervishi .Në cilësi të provës e ka bashkangjitur një raport .Mirëpo nga raporti policor, dt.06.11.2013 theksohet se në ora 00:40 shtatë kutit pasi që kanë përfunduar janë transportuar në Sallën e Sportit në Fushë Kosovë, ku gjatë kohës kemi kontaktuar me përgjegjësit e QNR dhe asnjëherë nuk ka pasur raport për ndonjë pa rregullsi . Pra në kohën sa kemi qëndruar në këtë pikëuk ka pasur asnjë ankesë nga qytetarët.
- Në ankesën Anr.472/13, pretendohet se, sot rreth orës 13:00, në shkollën fillore “Mihail Grameno” e njëjta qendër e vendvotimit VV nr.4, personat Bekim Rexha dhe Ruzhdi Raqi i kanë pasur të dytë dy duart e ngjyrosura ku edhe kanë votuar. Më tutje thekson se votimi iu është bërë i mundur pasi që me iniciativën e kryesueses kanë votuar. Parashtruesi i ankesës ka cekur në cilësi të dëshmitarëve personat Arbër Selmani, Gentrit Grajçevci, Liridon Gashi dhe Floret Dërishi . Në cilësi të provës e ka bashkangjitur një raport. Mirëpo nga raporti policor, dt.06.11.2013 theksohet se në ora 00:40 shtatë kutit pasi që kanë përfunduar janë transportuar në Sallën e Sportit në Fushë Kosovë, ku gjatë kohës kemi kontaktuar me përgjegjësit e QNR dhe asnjëherë nuk ka pasur raport për ndonjë pa rregullsi . Pra në kohën sa kemi qëndruar në këtë pikëuk ka pasur asnjë ankesë nga qytetarët.

- Në ankesën Anr.473/13, pretendohet se, sot më 03. Nëntor 2013, në Fushë Kosovë, në qendrën e votimit QV, në vendvotimin nr.4 personat Ruzhdi Raçi dhe Bekim Rexha iu është lejuar që të votojnë me iniciativen e kryesueses së vendvotimit edhe pse llampa identifikuese ka dhënë shenjë pasi që duart i kishin të ngjyrosura. Parashtruesi i ankesës ka cekur në cilësi të dëshmitarëve personat Arbër Selmani, Gentrin Grajçevci, Liridon Gashi dhe Floreta Dervishi . Në cilësi të provës e ka bashkangjitur një raport. Mirëpo nga raporti policor, dt.06.11.2013 theksohet se në ora 00:40 shtatë kutit pasi që kanë përfunduar janë transportuar në Sallën e Sportit në Fushë Kosovë, ku gjatë kohës kemi kontaktuar me përgjegjësit e QNR dhe asnjëherë nuk ka pasur raport për ndonjë pa rregullsi . Pra në kohën sa kemi qëndruar në këtë pikëuk ka pasur asnjë ankesë nga qytetarët.
- Në ankesën Anr..474/13, pretendohet se, në shkollën fillore “Mihail Grameno” i njëjti vendvotim komisionerët e LDK-së gjatë procesit të votimit kanë bërë me shenjë votuesve duke ngritur gishtërinjtë me qëllim të votimit të partisë përkatëse LDK, ku gjatë ditës janë ndëruar tre komisionarë. Parashtruesi i ankesës ka cekur në cilësi të dëshmitarëve Valon Islamit dhe Merita Popova. Në cilësi të provës e ka bashkangjitur një raport.

PZAP-i, në bazë të nenit 6.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it ka vendosur ti bashkoi ankesat e lartcekura dhe ti trajtoi si një ankesë, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve dhe për të gjitha të vendos me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

ankesat janë të pabazuara

Me nenin 118.4 të LZP-së parashihet se : *“Mund të apelohe vendimet e PZAP-it, sikurse PZAP-i mund ti rishikoj cilindo nga vendimet e marra pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar”*.

Pretendimet ankimore nga ana e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Fushë Kosovë, ndaj Ibrahim Xhakollit ku e njëjta ia ka bërë të mundur të votojë në mënyrë të pa rregullt personave Ruzhdi Rexha dhe Bekim Rexha, ndërsa në objektin Mihail Granera me lejen e votuesve Bekim Rexha dhe Ruzhdi Raçi janë lejuar të votojnë edhe përkundër faktit se kishin duart e spërkatura, po ashtu personat Ruzhdi Raçi dhe Bekim Rexha iu është lejuar që të votojnë me iniciativen e kryesueses në vendvotim dhe komisionerët e LDK-së gjatë procesit të votimit kanë bërë me shenjë votuesve duke ngritur gishtërinjtë me qëllim të votimit të partisë përkatëse LDK, në bazë të nenit 3.6 pika c të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it nuk është bashkangjitur asnjë provë nga pala ankuese, me të cilat do të mund të verifikoheshin shkeljet e supozuara.

Andaj për shkakun se nuk janë ofruar dëshmi bindëse për të vërtetuar se kanë ndodhur dhe janë evidentuar pa rregullsitë gjatë procesit të votimit në VV e lartpërmendura nga parashtruesi i ankesës, PZAP-i, në kuptim të nenit 118 paragrafit 1 të LZP-së, ankesat e lartpërmendura u refuzuan si të pa bazuara. Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 471/2013 më datën 07.11.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Hasan Shala**

Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.

